

Thirrja nga data 01.11.2024 deri në datën 08.11.2024

TERMAT E REFERENCES

HULUMTUES/E MBI TEMEN ‘VLERËSIMI I ZBATIMIT TË LIGJIT PËR MBROJTJËN E FËMIJËS NË SHKOLLAT FILLORE DHE INSTITUCIONET E KOMUNËS SË PRIZRENIT PËR EDUKIMIN DHE ARSIMIMIN, RAPORTIMIN E RREZIKUT, QASJA E SHPEJTË NË DREJTËSI, QASJA E FËMIJËVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR/A’.

"Vlerësimi i zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës në shkollat fillore dhe institucionet e komunes së Prizreni për Edukimin dhe Arsimimin, Raportimi i rrezikut, Qasja e shpejtë në drejtësi, Qasja e fëmijëve me aftësi të kufizuar(a)".

Të dhënat mbi OJQ “Nevo Koncepti” dhe kërkesat për shërbimin e hulumtimit.

Organizata	OJQ “NEVO KONCEPTI
Objektiva	Zhvillimi dhe ofrimi i Hulumtimit në temën "Vlerësimi i zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës në shkollat fillore dhe institucionet e komunes së Prizreni për Edukimin dhe Arsimimin, Raportimi i rrezikut, Qasja e shpejtë në drejtësi, Qasja e fëmijëve me aftësi të kufizuar(a)" për anëtarët e Asambleve Komunale të Fëmijëve (AKF) në Prizren

1. TË DHËNAT MBI ORGANIZATËN

OJQ “Nevo Koncepti” është organizatë joqeveritare e themeluar më 26 Nëntor 2014. Në themelimin e OJQ “Nevo Koncepti” kanë marrë pjesë intelektualë të komunitetit Romë të cilët për shumë vite janë angazhuar në forma të ndryshme dhe kanë kontribuar në fuqizimin dhe avancimin e pozitës së komunitetit Rom në pjesë të ndryshme të Kosovës sikurse në Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Pejë, Rahovec, Fushë Kosovë, Suharekë etj.

OJQ “Nevo Koncepti” bashkëpunon me fëmijë, të rinjë dhe familje të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian, me institucionet publike qendrore dhe lokale, organizata të shumta vendore dhe ndërkombëtare, media dhe palë tjera me interes.

OJQ Nevo Koncepti nga viti 2022 të muajit Qershor ka filluar të zbatojë projektin “Qeverisja e të Drejtave të Fëmijëve” në Komunën e Prizrenit, asambleja përbëhet nga 45 antarë të cilët përfaqësohen nga 13 shkollat e mesme të ulëta të komunës së Prizrenit. Në Asamblesë Komunale të Fëmijëve janë të përfshirë komunitetet Rom, Shqiptar, Turk, Boshnjak, Ashkali dhe Egjiptian, gjithashtu në Asamblesë Komunale të Fëmijëve përfaqësohen edhe fëmijët me aftësi të kufizuara të cilët marrin pjesë në aktivitete të ndryshme të cilat organizohen nga antarët e Asamblesë Komunale të Fëmijëve.

Aktualisht OJQ “Nevo Koncepti” është duke zbatuar 5 projekte në fusha të ndryshme të cilat synim themelor kanë fuqizimin dhe përmirësimin e pozitës së komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptian.

2. INFORMATA TË PËRGJITHSHMË RRETH PROJEKTIT

”Qeverisja e të Drejtave të Fëmijëve” është projekt i implementuar nga Nevo Koncepti në partneritet me Save the Children Kosova/o dhe financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida). Qëllimi i projektit është avokimi për të drejtat e fëmijëve dhe ngritja e pjesmarrjes së fëmijëve në vendimmarrje në nivel lokal gjatë hartimit të politikave dhe gjatë organizimit të ngjarjeve nga komuna e Prizrenit nëpërmjet krijimit të Asamblesë Komunale të Fëmijëve në nivel të komunës nga 13 shkollat fillore të mesme të ulta të komunës së Prizrenit.

Asambleja Komunale e Fëmijëve të Prizrenit është krijuar në vitin 2017 dhe përbëhet nga 43 Asamblesitë të cilët përfaqësohen nga 13 shkollat. Asambleja ka për qëllim avokimin dhe mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.

3. OBJEKTIVA

Vlerësimi i zbatimit të ligjit për mbrojtjen e fëmijës në shkolla dhe institucione, e cila duhet të analizohet masat që janë marrë për të përmbushur kërkesat ligjore për mbrojtjen e fëmijëve dhe për të identifikuar hendekët ose sfidat në zbatimin e tyre. Monitorimi i mekanizmave të raportimit të rrezikut, e cila do të vlerësohet efektiviteti i sistemit të raportimit të rrezeve dhe abuzimit ndaj fëmijëve, përfshirë mënyrën se si adresohen raportimet dhe si mbrohen të drejtat e fëmijëve, Analiza e qasjes së shpejtë në drejtësi për fëmijët në nevojë, të shqyrtohen se si fëmijët dhe prindërit e tyre mund të aksesojnë sistemin e drejtësisë dhe të marrin mbrojtje të shpejtë dhe efektive kur ka raste të abuzimit apo rrezikut. Vlerësimi për përfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuar, gjithashtu duhet të vlerësohet nëse fëmijët me aftësi të kufizuar kanë qasje të barabartë në arsim dhe mbrojtje ligjore, si dhe nëse janë marrë masat e duhura për të përmbushur nevojat e tyre. Hulumtuesi/ja duhet të ndjekë një proces të mirëstrukturuar për të vlerësuar zbatimin e ligjit për mbrojtjen e fëmijës në shkollat fillore dhe institucionet e komunës disa nga hapat të cilat duhet të ndjekur dhe të cilat përfshijnë procesin e hulumtimit janë:

1) Shqyrtimi i literaturës dhe kornizës ligjore, 2) Hartimi i metodologjisë së hulumtimit, 3) Mbledhja e të dhënave, 4) Analiza e të dhënave, 5) Rekomandimet dhe raportimi, 6) Komunikimi dhe avokimi,

Sipas 6 pikave të strukturuar do të ndihmojë hulumtuesin/sen, për të zhvilluar një analizë të plotë dhe të informojë për ndryshimet e nevojshme për të siguruar mbrojtje efektive për fëmijët.

OJQ Nevo Koncepti, kërkon një individë (Hulumtues/e), për të ofruar dhe zhvilluar hulumtimin për fëmijët e Asamblesë Komunale të fëmijëve, grup moshë e fëmijëve 12- 15 vjeçar/e.

4. PËRVOJAT SHKATHETISITE E NEVOJSHME DHE KUALIFIKIMI

- Hulumtuesi/ja duhet të ketë aftësitë për të komunikuar me fëmijë, mbledhjen e informacioneve rreth hulumtimit dhe njohurinë të nevojshme temës.
- Hulumtuesi/ja duhet të përpiloj materialin hulumtues së bashku me Asamblenë Komunal të Fëmijëve.
- Diplomë pasuniversitare (preferohet niveli Master) në shkencat shoqërore,

- 5-7 vjet përvojë pune si Hulumtues/e, duke përfshirë hartimin e hulumtimeve dhe ofrimin e programeve
- Shkathësi të mira komunikimi, organizative, të punës interaktive dhe qasje mësimore adaptive dhe dinamike për të siguruar që të mësuarit përshtatet nevojave të pjesëmarrësve
- Njohuri dhe shkathësi për të komunikuar dhe punuar me fëmijë dhe të rinj
- Kreativ, i/e hapur, motivues dhe që pranon sugjerimet
- Të punoj në përputhje me politikat e NVK sa i përket respektimit të të drejtave të fëmijëve.
- Respekton afatet kohore
- Të jetë fleksibil për tu përshtatur me orarin e përfaqësuesve të Asamblesë Komunale të Fëmijëve (AKF), për të caktuar ditën e takimeve.
- Të punojë në përputhje me politikat e Nevo Konceptit, sa i përket Child Safeguarding mbi respektimin e të drejtave të fëmijëve.
- Të nxjer rezultatet përfundimtare të hulumtimit dhe ta përpiloj raportin përfundimtar së bashku me Asamblenë e Fëmijëve.
- Të ketë ekspertizë mbi temën e lartëcekur (kandidatët preferohet të kenë qertifikime mbi temën)

5. AFATI KOHOR

Puna duhet të filloj nga data 11.11.2024 deri më 11.12.2024 Raporti duhet dorëzuar në përfundim të hulumtimit të bashkangjitur si dokument i shtuar.

Numri i rezultatit	Titulli i rezultatit	Përshkrimi	Ditët e punës	Data e rezultatit
1	Përgatitja e programit të Hulumtimit	Zhvillimi / adaptimi i programit të Hulumtimit, përfshirë materialet e hulumtimit si dhe të formojë vlerësimin me Para dhe Pas Test për "Vlerësimi i zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës në shkollat fillore dhe institucionet e komunes së Prizreni për Edukimin dhe Arsimimin, Raportimi i rrezikut, Qasja	5	Nëntor 2024

		e shpejtë në drejtësi, Qasja e fëmijëve me aftësi të kufizuar(a)".		
2	Ofrimi i programit të Hulumtimit, formimi i pyetjeve me Asamblenë Komunale të Fëmijëve dhe shpërndarja në 13 Shkolla të Mesme të Ulëta në komunën e Prizrenit.	Ofrimi i 2 takimeve me Anëtarët e Asamblesë Komunale të Fëmijëve dhe shpërndarja e pyetjeve të hulumtimit në 13 SHFMU të komunës së Prizrenit	10	Nëntor 2024
3	Raporti i dalur me rekomadimet e nga Hulumtimi dhe dorëzimi i raportit përfundimtar mbi angazhimin.	Hartimit i raportit të Hulumtimit dhe të gjeturat e sajë dhe Raporti përfundimtarë mbi angazhimin në hulumtim për "Vlerësimi i zbatimit të Ligjit për Mbrojtën e Fëmijës në shkollat fillore dhe institucionet e komunes se Prizreni për Edukimin dhe Arsimimin, Raportimi i rrezikut, Qasja e shpejtë në drejtësi, Qasja e fëmijëve me aftësi të kufizuar(a)".	8	Nëntor 2024
	Gjithsej:		23	

6. REZULTATET E PRITSHME

- Zhvillimi i përmbytjes së përgjithshme të planit të hulumtimit, përfshirë ditët e punës me fëmijët dhe agjenden.
- Materialet për shpjegimin se si bëhet një hulumtim e cila do ti shërbej AKF për tu udhëzuar.
- AKF të përfitojë njohuri lidhur me procedurat e hulumtimit.

PROCEDURA E APLIKIMIT

Aplikacionet duhet të dërgohen duke i përfshirë këto dokumente;

- CV / Të ketë eksperiencë profesionale në realizim të hulumtimeve dhe të ketë eksperiencë paraprake në punë me fëmijë.
- Një kopje të elektronike të ndonjë hulumtimi paraprak.
- Dy (2) referencë
- Shprehja e interesit
- Oferten Financiare dhe
- Dokument i cili deshmon që aplikuesi/ja nuk është nën hetime.

Aplikimi duhet të dërgohet tek;

Menaxheri i Projektit, Elmedin Qylangjiu e.qylangjiu@nevokoncepti.org duke e shtuar ne CC Drejtorin Ekzekutiv të Nevo Konceptit z.Osman Osmani, o.osmani@nevokoncepti.org jo më larg se data 08.11.2024.